


Manushaqe Arifaj, Fabjola Zhabina, Moralda Durra



Nga punimet me xhubletën, te rikrijimi i jorganëve në miniaturë dhe eksplorimi i "shtegut të dverve të vjetra" të Durrësit – pjesëmarrësit u angazhuan me teknika artizanale që sjellin muzeun jashtë mureve të tij.



Po me pelqen te qep jorgan. Kur do te vini perseri? ★★★★★

Artizianat / Tekstil

Trashëgimia merr jetë përmes praktikave krijuese që zbulojnë motive të larëta e modeie.



Stimuluese dhe motivuese, këto aktivitete krijuan jo vetëm objekte, por edhe momente të ngrohta.

Dea Ymeraj, Klevis Golemaj

Krijimtari me Argjilë

Në duart e fëmijëve dhe të rriturve, argjila u shndërrua në një udhëtim në kohë. Ata krijuan lodra të frymëzuara nga periudha parahistorike, dhe lodrave tipike shqiptare, si dhe motive arkitekturore të banesave të vjetra të Durrësit.



Mirjana Mecaj, Donald Llaperi

Art Kreativ

Në këtë hapësirë, imagjinata nuk njih kufij: nga stampat me motive të hamamit, te teknika quilling për simbolet e ndërtesave historike të Durrësit.

Pjesëmarrësit ndërtuan histori të reja mbi bazat e së kaluarës, duke eksperimentuar me forma, ngjyra dhe tekstura. Një praktikë kreative dhe motivuese, që mbushi ambientin me energji, angazhim dhe buzëqeshje.



Pjesëmarrësit lidhën historinë me përgjetimet e tyre regionale.



Me pelqeu qe punova me argjile simbole te shtepive te vjetra. Aktivitet frymzues dhe gjithepeshires. ★★★★★



Eksperience qe do te doja ta provoja perseri. Eksperimenti me hamamin ishte super. ★★★★★



Romina Demiraj, Ramtiz Maliqati, Endrit Hyseni

Teknologjia dhe trashëgimia



Objektet e koleksionit morën jetë të re përmes artit digjital, duke krijuar motive bashkëkohore të frymëzuara nga trashëgimia. Kjo qasje solli një eksperiencë dinamike dhe gjithëpërfshirëse. U testua edhe aplikacioni interaktiv i Xhubletës, që ofron mënyra të reja për të eksploruar historinë dhe simbolikën e saj. Së bashku, këto aktivitete krijuan një përvojë të pasur që lidh kreativitetin modern me trashëgiminë kulturore.

I'm Stephanie and I liked it very much. It was an interesting activity and I enjoyed making this. ★★★★★



HERITAGE HUB

Trashëgimia për përfshirjen sociale



Projekti “Heritage Hub” synon zhvillimin e turizmit kulturor dhe afrimin e komunitetit me trashëgiminë përmes përfshirjes së artistëve të rinj dhe krijuesve inovativë. Ai ndërthur njohuritë tradicionale me krijimtarinë bashkëkohore, duke krijuar formate të reja kulturore në hapësira muzeale. Projekti promovon bashkë-krijimin, reflektimin dhe përfshirjen sociale. Npërmjet praktikave artistike dhe edukative, Heritage Hub mbështet zhvillimin personal të krijuesve të rinj, rrit angazhimin qytetar me kulturën lokale dhe kontribuon në një mjedis kulturor të hapur, inkluziv dhe të qëndrueshëm.

Ky projekt mbështetet nga Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit



Feedback dhe vlersime

- * I'm Stephanie and I liked it very much. It was an interesting activity and I enjoyed making this.
- * Hello, we came here from Romania to visit Dures and we find this activity in the center of Dures. We think it's very nice how you try to promote your museum and our girls just like to play here with the modulating toys.
- * Eksperimenti me hamamin ishte super.
- * Eksperienc që do të doja ta provoja përsëri.
- * Cdo gjë ishte shumë e bukur.
- * Më pëlqeu që punova me argjilë simbole të shtëpive të vjetra.
- * Fëmijët e shijuan dhe u knaqën shumë njëkohësisht. Aktivitet shumë i bukur! Ide shumë e bukur për të përfshirë fëmijët dhe për ti argetuar ata.
- * Kur do te vini përsëri?
- * Me rikthyet fëmijërinë.
- * Mund të më tregosh si ta bëj?
- * Cfarë aktiviteti është ky? Qënka interesant
- * Shumë bukur e keni organizuar.
- * U kënaqa që erdha sot këtu.



Mirjana Mecaj
09.06.2025 oborri i
Hamamit të Durrësit



Klevis Golemaj
Dea Ymeraj
10.07.2025 shëtitorja
pranë Kullës
Veneciane, Durrës



Mirjana Mecaj,
Dea Ymeraj
20.06.2025
Porta e Kalasë, pranë
Amfiteatrit Durrës



Data 12.09.2025
Muzeh Lab, Durrës



Data 28.10.2025
Muzeh Lab, Durrës



Morfa (Moralda Durra,
Fabjola Zhuba),
Manushaqe Arifaj

02.07.2025 shëtitorja
pranë Tendës së Bardhë
Plazh, Durrës



Takim me artistët
Muzeh Lab, Durrës
28.06.2025



Morfa (Moralda Durra,
Fabjola Zhuba),
Manushaqe Arifaj

01.08.2025
shëtitorja pranë Grand
Blue Fafa Resort, Golem



Donald Llaperi,
Dea Ymeraj

20.07.2025
shëtitorja në Golem



Donald Llaperi,
Mirjana Mecaj

25.07.2025
shëtitorja pranë Grand
Blue Fafa Resort, Golem

STATISTIKA :

Nr total i pjesëmarrësve	226
nr i femrave	147
nr i meshkujve	79
nr i personave < 18 vjeç	124
nr i personave >18 vjeç	94

Idërtthurja e njohurive tradicionale me krijimtari inovative,

Projekti “Heritage Hub” është një iniciativë që synon të zhvillojë turizmin kulturor dhe të afrojë komunitetin me trashëgiminë përmes përfshirjes aktive të artistëve të rinj dhe krijuesve inovatorë. Ai ndërthur traditën me krijimtarinë bashkëkohore, duke krijuar hapësira laboratorike ku eksperimentohen forma të reja të shprehjes artistike dhe kulturore në muze dhe mjedise publike.

Qëllimi kryesor i projektit është transformimi i njohurive tradicionale në procese krijuese që nxisin bashkë-krijimin dhe reflektimin mbi trashëgiminë kulturore, duke e bërë atë më të afërt dhe të gjallë për qytetarët. Heritage Hub kontribuon në zhvillimin e formateve kulturore inovative që integrojnë artin, edukimin dhe përfshirjen shoqërore, duke e kthyer Durrësin në një qendër të hapur dhe dinamike të kulturës.

Projekti mbështetet në energjinë dhe idetë e reja të artistëve të rinj, duke krijuar modele të praktikave kreative që mund të aplikohen edhe në mjedise të tjera muzeale, arkeologjike dhe urbane. Këto modele shërbejnë për të nxitur mirëqenien, përfshirjen sociale dhe zhvillimin personal të pjesëmarrësve.

